



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Dërgimin në gjyq të çështjes penale nr. 136, datë 19.12.2019, në ngarkim të të pandehurve **Talo Çela**, etj...”.

2. Gjykimi i kësaj çështje u zhvillua me rregullat e gjykimit të zakonshëm. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët Erjon Bani, Rudina Palloj dhe Elsa Ulliri, me vendimin Nr. **69**, datë **21.11.2024** vendosi:

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Talo Jonuz Çela**, për kryerjen e veprës penale “**Vjedhja me armë**”, e kryer në formën e veçantë të bashkëpunimit atë të grupit të strukturuar kriminal, “*Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*” parashikuar nga neni 140 dhe në lidhje me nenin 28/4 dhe 334/1 të Kodit Penal, dënimin e tij me **17 (shtatëmbëdhjetë) vjet burgim**.
2. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Talo Jonuz Çela**, për kryerjen e veprës penale “**Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit**”, e kryer në formën e veçantë të bashkëpunimit atë të grupit të strukturuar kriminal, “*Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*” parashikuar nga neni 278/1 (sipas përmbajtjes së kësaj dispozite para ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 44/2019, datë 18.7.2019) dhe në lidhje me nenin 28/4 dhe 334/1 të Kodit Penal, dënimin e tij me **8 (tetë) vjet burgim**.
3. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Talo Jonuz Çela**, për kryerjen e veprës penale “**Grupi i strukturuar kriminal**”, e parashikuar nga neni 333/a/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me **3 (tre) vjet burgim**.
4. Bazuar në nenin 55 të Kodit Penal, në bashkim të dënimeve i pandehuri **Talo Jonuz Çela**, dënohet me një dënim të vetëm prej **18 (tetëmbëdhjetë) vjet burgim**.
5. Vuajtja e dënimit të kryhet nga i pandehuri **Talo Jonuz Çela**, në një burg të sigurisë së lartë, në respektim të nenit 16 pika 1, gërma “a” të Ligjit Nr. 81/2020 “PËR TË DREJTAT DHE TRAJTIMIN E TË DËNUARVE ME BURGIM DHE TË PARABURGOSURVE”.
6. Në bazë të nenit 190 të K.Pr.Penale, sendet e sekuestruara të mbeten në ruajtje për efekt të procedimit penal të ndarë me nr. 136/1, të vitit 2020.

7. Shpenzimet proceduriale të bëra gjatë hetimeve paraprake si dhe ato gjyqësore i ngarkohen të pandehurit.
8. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, brënda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.

Tiranë, më datë 21.11.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar